

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Global Services Firm” shpk**

**Neni 1
Ortakët themelues**

1.1 Shoqëria krijohet nga ne ortakët themelues:

- Znj. Alba Bicja, shtetase Shqiptare, lindur më 01.03.1989, në Tiranë, Shqipëri, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar;

- Znj. Luella Liçi, shtetase shqiptar, lindur më 08.02.1989, në Tiranë, Shqipëri, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

**Neni 2
Emërtimi**

2.1 Shoqëria emërtohet **“Global Services Firm” shpk.**

**Neni 3
Forma juridike**

3.1 Forma juridike do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.) sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”.

**Neni 4
Selia**

4.1 Selia e Shoqërisë “Global Services Firm” shpk është: Rruga e Thesarit, njësi, kati I, Linzë, Tiranë.

**Neni 5
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria “Global Services Firm” shpk ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë “Global Services Firm” shpk, do të ketë për objekt:

“Shërbim në fushën e përkthimit dhe interpretimit nga gjuha shqipe drejt gjuhëve të huaja, dhe anasjelltas. Konsulencë ligjore dhe shërbim avokatie, gjerimi i punëve të tjerëve (sipas parashikimeve të nenit 648-652 të Kodit Civil), ushtrimi i aktivitetit të agjensisë/agentit tregtar (sipas parashikimeve të nenit 950 e vijues të Kodit Civil) dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji. Përfaqësimi në Gjykatë dhe mbrojtja e interesave të klientëve të shoqërisë për çështje të ndryshme. Shërbimin Call Center. Agjenci për ndërmjetësim tregtar dhe konsulencë për personat fizik, juridik, publik apo privatë, të institucioneve dhe enteve publike, në lidhje me çdo problematike eventuale etj, plane biznesi dhe marketingu, analizë tregu, organizim e menaxhim eventesh, trajnimesh e konferencash. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.”

5.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakësohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 6
Kohëzgjatja**

6.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

**Neni 7
Kapitali i Shoqërisë**

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë “Global Services Firm” shpk përfaqësohet nga 2 (dy) kuota me vlere 100,000 (një qind mijë) lekë dhe nuk është paguar.

7.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë:



- Znj. Alba Bicja, zotëruese e 1 (një) kuote me vlere të përgjithshme 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Znj. Luella Liçi, zotëruese e 1 (një) kuote me vlere të përgjithshme 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 8

Transferimi i kuotave

8.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit

Neni 9

Asambleja e Përgjithshme

9.1 Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet që ligji apo Statuti ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

9.2 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen në një regjistër të posacëm të mbajtur pranë selisë së Shoqërisë “Global Services Firm” shpk.

9.3 Janë në kompetencën ekskluzive të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve marrja e vendimeve për sa i përket:

- a) ndryshimit të Statutit;
- b) riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi, shndërrimi i shoqërisë;
- c) zmadhimi, zvogëlimi i kapitalit, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar nga vetë shoqëria me qëllim anulimin e tyre;
- d) emërimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- e) emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të autorizuar;
- f) miratimi i bilancit;
- g) si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblesë

Neni 10

Organet drejtuese

10.1 Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

Neni 11

Administratori i Shoqërisë

11.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, person fizik që mund të jetë ose jo ortak i Shoqërisë.

11.2 Administratori është të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Statutin, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

11.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do të qëndrojë në detyrë për një kohë prej 5 (pese) vjetësh.

11.4 Administratori i parë i shoqërisë emërohet:

- a) Znj. Alba Bicja, shtetase Shqiptare, lindur më 01.03.1989, në Tiranë, Shqipëri, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

11.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeht ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

Neni 12

Ligji i zbatueshëm dhe mosmarrëveshjet

12.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.

12.2. Për të gjitha mosmarrëveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12.3. Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.



Neni 13

Regjistrimi i shoqërisë në QKB

13.1 Për regjistrimin e shoqërisë “Global Services Firm” shpk pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, emërohet administrator i shoqërisë.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortakët themelues

ORTAKËT THEMELUES

Alba Bicja



Luela Liçi



Data: 02.05.2023